



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E PERGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

DREJTORIA E KONTROLLIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Proces – Verbal

Dëgjesa e dytë publike për Planin e Detajuar Vendor të nën-njesisë strukturore 01_02

Data: 02.08.2017

Në datën **02.08.2017** në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak, Bashkia Fier organizoi dëgjësën e dytë publike për hartimin e Planit të Detajuar Vendor të nën-njesisë strukturore 01_02. Ky proces do të zhvillohet në sajë të punës së kryer nga ekipi i specialistëve të Drejtorisë së Projekteve të Infrastrukturës. Dëgjesa fokusohet në prezantimin propozimit për zhvillimin e nën-njesisë së marrë në studim, si dhe mbi marrjen e sygjërimeve nga ana e pjesëmarrësve në dëgjësë.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të bashkisë, njësive administrative, Komisionit Këshillimor Qytetar, Prefekturës Fier, si dhe disa qendra sociale e qytetarë të zonës.

Nisma u prezantua nga specialisti i Drejtorisë së Projekteve të Infrastrukturës, z. Erigels Myrtaj, pas fjalës hyrëse të zëvendës/kryetares së Bashkisë Fier, znj. Enkelejda Peshkëpia. Materiali i përgatitur përmbante këto pika :

1. Plani i propozuar i truallit (analizë mbi ndarjen e zonave të rekreativitetit dhe zonave për ndërtim dhe konsolidim)
2. Plani i propozuar i përdorimit të hapësirave
3. Plani i propozuar i zhvillimit (intensiteti i parashikuar nga plani rregullues ishte 4.0, ndërsa intensiteti i propozuar nga studimi i planit të detajuar është 2.78)
4. Plani i propozuar i ndarjes së hapësirave
5. Plani i propozuar rrugëve kufizuese
6. Plani i propozuar i rrjetit elektrik
7. Plani i propozuar i rrjetit të telekomunikacionit
8. Plani i propozuar i rrjetit të ujësjellësit
9. Plani i propozuar i rrjetit KUZ

Dëgjesa zgjati rreth 1 orë dhe pati një diskutim konstruktiv mbi propozimin e planit dhe mbi përpikmërinë në zbatimin e planit. Propozimi për intensitetin 2.78 do të bëjë të mundur që zona të ketë më shumë lirshmëri në hapësira, gjelbërim dhe të mos tejkalojë lartësinë e objekteve përreth zonës së marrë në studim. Takimi u mbyll pa kundërshtime, duke marrë kështu edhe pëlqimin nga ana e qytetarëve për miratimin e Planit të Detajuar Vendor të nën-njesisë strukturore 01_02.